



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Platime: 22-09-2016

Nr. Org.	02-013/92	Titulli	Titulli
Nr. Org.		Titulli	Titulli



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për vetëqeverisjen Lokale nr 03/L-040 Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës 2008/28, nenit 51.1 të Statutit të Komunës së Vitisë nr 01-013/491 të datës 21.04.2011, dhe Memorandum Mirëkuptimi për bashkëfinancim për projektin e automjetit me shkallë për njësinë e zjarrfikësve në Viti nr.02-07/967 të datës 29.07.2016 Kryetari i Komunës së Vitisë bien këtë:

V E N D I M

PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE NË SHUMË PREJ 417.80€ PËR SIGURIMIN DHE REGJISTRIMIN E AUTOMJETIT PËR NJËSINË E ZJARRFIKËSVE

I.

Me këtë Vendim, Kryetari i Komunës së Vitisë **NDAN** mjete financiare në shumë prej 417.80€ me shkronja (katërqind e shtatëmbëdhjetë euro e tetëdhjetë cent), në emër të pagesë së shpenzimeve për regjistrimin e automjetit të Njesisë së Zjarrfikësve në Viti.

Komuna e Vitisë në Gusht të këtij viti ka siguruar një automjet për njësinë e zjarrfikësve në Viti – kamionin e markës Mercedes Unimog, Tipi U 1200 Diesel, Ngjyra e kuqe/hiri, 2 dyer, 3 ulëse, Com 5672 kw;50 Regjistrimi i par 1985. Numri i shasisë 424 122 101136 92 i cili duhet të sigurohet dhe regjistrohet por nuk është në listën e automjeteve të operatorit ekonomik me të cilën Komuna ka kontratë për sigurimin e automjeteve të Komunës.

II.

Mjetet nga neni 1 i këtij Vendimi, sigurohen nga Buxheti i Komunës së Vitisë për vitin 2016 nga kodi buxhetor për shërbime dhe mallra i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë.

III.

Për zbatimin e këtij Vendimi, do të kujdeset Kryetari i Komunës, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë dhe Zyrës së Thesarit e Komunës së Vitisë.

IV.

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Komunës së Vitisë.

Viti, 21.09.2016

KRYETARI I KOMUNËS SË VITISË

Sokol Haliti

Vendimi u dorëzohet:

1. Drejtorisë për Sh.P. dhe Emergjencë
2. Zyrës së thesarit dhe
3. Arkivi